



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6167 Prot.

Roskovec, më 25.10 2019

VENDIM

NR. 92 .DATË 23.10 .2019

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES URBANE PËR BLOKUN NR.2,QENDËR
,ROSKOVEC”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, neni 54 pika 1 gërma k); ligjin 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e Rregullores Urbane për Bllokun Nr.2,Qendër Roskovec, bashkëngjitur këtij vendimi.
- 2- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit,Drejtoria e Shërbimeve dhe Drejtoria Juridike për zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. - prot

Roskovec, më 23 110 / 2019

RREGULLORE URBANE
PËR
BLLOKUN NR.2, QENDËR, ROSKOVEC

ROSKOVEC, 2019

TABELA E PËRMBAJTJES

1. **HYRJE**.....
2. **RREGULLA TË PËRGJITHSHME**.....
 - 2.1. Titulli.....
 - 2.2. Objekti.....
 - 2.3. Qëllimi
 - 2.4 Baza Ligjore.....
 - 2.5 Harta e Bllokut Nr.2 Qendër Roskovec.....
3. **RUAJTJA E IDENTITETIT URBAN**.....
 - 3.1. Ndërtesat
 - 3.2. Çatia Dhe Detajet E Çatisë.....
 - 3.3. Ngjyrat Dhe Detajet.....
 - 3.4. Fasadat e Dyqaneve dhe Reklamat.....
 - 3.5. Parkimi.....
 - 3.6. Qarkullimi i Mjeteve Motorrike.....
4. **RREGULLA PËR ELEMENT TË NDRYSHËM URBAN**
 - 4.1. Kioskat dhe Reklamat.....
 - 4.2. Rrethimi dhe Portat
 - 4.3. Tendat
 - 4.4. Grilat
 - 4.5. Kondicionimi
 - 4.6 Antenat
5. **AKSEIBILITETI I HAPËSIRAVE PUBLIKE DHE RRJETIT RRUGOR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR**
 - 5.1 Lëvizshmëria fizike.....
6. **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**
 - 6.1 Zbatueshmëria
 - 6.2 Penalitetet
 - 6.3 Hyrja ne fuqi.....
7. **DISPOZITA KALIMTARE**

1. HYRJA

Në mbështetje të ligjit Nr 107/2014 , “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, Bashkia Roskovec ka hartuar “*Rregulloren Urbane për Bllokun Nr.2, Qendër, Roskovec*”.

Rregullorja është një ligj lokal për zhvillimin e territorit, përcakton në mënyrë të ngurtë dhe të pandryshueshme rregullat, normat, standardet dhe treguesit e zhvillimit në territorin administrativ që mbulon Bashkia Roskovec.

2. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

2.1 Titulli

Ky dokument do të njihet si “*Rregullore Urbane e Bllokut Nr .2 ,Qendër ,Roskovec*”.

2.2 Objekti

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave, normave dhe standardeve lidhur me përdorimin e tokës,parametrat e zhvillimit dhe elementet e ndryshëm urban ,në territorin e Bllokut Nr.2, Qendër , në qytetin e Roskovecit ,Bashkia Roskovec.

2.3 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje urbane , është të përcaktoj rregulla, norma, standarde dhe instrumente të zbatueshme, si dhe të orientojë procedurat, për përdorimin dhe zhvillimin ekzistues dhe të ardhshëm të tokës në këtë pjesë të territorit nën juridiksionin e Bashkisë Roskovec.


Gjithashtu, zbatimi i kësaj rregulloreje synon që të garantojë se propozimet për sektorin publik dhe privat, të jenë të balancuara dhe të harmonizojnë interesat e të dyja palëve, duke përmbushur objektivat që vetë Bashkia ka vendosur.

2.4 Baza ligjore

Hartimi i rregullores së planifikimit të territorit ka ndjekur drejtime të qarta të cilat mbështeten në kuadrin e plotë ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

- Ligji Nr. 107/2014 , “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar;
- VKM Nr.408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “*Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit*”;
- Ligji Nr. 10 440, datë 07.07.2011 “*Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis*”, i ndryshuar;

Harta territoriale e Bllokut Nr. 2 Qendër Roskovec.



3.6 Qarkullimi i mjeteve motorrike

Brenda territorit të Bllokut nr.2 ndalohet qarkullimi i mjeteve motorrike.

Qarkullimi i mjeteve motorrike lejohet vetëm në vendet e caktuara nga Bashkia Roskovec.

4. RREGULLA PËR ELEMENT TË NDRYSHËM URBAN

4.1 Kioskat dhe Reklammat

Lejohet që subjekti të vendos pajisje publicitare vetëm pasi ai të jetë pajisur me autorizimin përkatës të lëshuar nga organet kompetente pranë Bashkisë Roskovec.

Instalimi i kioskave dhe reklamave nuk do të bëhet burim i ndonjë shqetësimi ose dëmtimi për ambjentin perreth. Në veçanti reklammat ndriçuese nuk do të shqetësojnë banesat në krah ose ato përballë.

Autoritetet e qytetit, kanë të drejtë të përcaktojnë hapësirat e përshtatshme për vendosjen, instalimin ngjitjen e reklamave brenda kufijve të qytetit, duke përcaktuar në çdo kohë, që distanca e tyre nga rruga, të jetë në përputhje me ligjet në fuqi.

4.2 Rrethimi dhe portat

Portat me pamje të plotë apo të pjeshme nga hapësirat publike, do të jenë në përputhje me standartet e përgjithshme të ndërtimit.

Rrethimet nuk do të pengojë vizibilitetin apo të rrezikojë rrjedhen e sigurtë të trafikut.

Rrethimet nuk duhet të bllokojnë fushën e shikimit të përcaktuar në dispozitat e përgjithshme .

Ndalohet që rrethimi të ketë mbyllje nga ana ballore dhe anësore përgjatë rrugës kryesore .

Rrethimi do të jetë i unifikuar dhe i autorizuar nga organi kompetente pranë Bashkisë Roskovec.

Strukturat duhet ti rezistojnë kushteve atmosferike ,për këtë duhet të jenë të fiksuara mirë në truall në mënyrë që të mos përbëjnë asnje rrezik për kalimtarët.

4.3 Tendat

Dizajni i tendave duhet të jetë në favor të stilit, shkallës, formës dhe periudhës së ndërtesës.

Tendat e përdorura duhet të jenë të unifikuara në formë ,material ,dizajn dhe ngjyrë e cila do të jetë e njëjtë me ngjyrën dominante të fasadës dhe të jetë i autorizuar nga organi kompetente pranë Bashkisë Roskovec.

Tenda nuk duhet të jetë aq e madhe sa të fsheh fasadën e ndërtimit.

Nuk lejohet përdorimi i tendave për hijëzimin e dritareve dhe nuk duhet që tenda të erresoje fasadën e ndërtesës apo detajet arkitektonike .

Tendat ekzistuese të cilat nuk janë të unifikuara në formë,material ,dizajn, dhe nuk janë në ngjyrën dominante të fasadës ,duhet të hiqen dhe të zvendësohen me tenda të unifikuara nga Bashkia Roskovec.

7. DISPOZITA KALIMTARE

Për rregullat dhe kriteret të cilat nuk janë të parashikuara në këtë rregullore do të zbatohen ato rregulla të përcaktuara në Ligjin Nr. 107 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" ,i ndryshuar; VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit"; VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar.

Përgatitën :

Sp/Juriste në Sektorin e Planifikimit dhe lejeve të Ndërtimit

Irena Blea

Drinalda Fejzulla

Përgjegjëse e Sektorit të Projektimit

Ark.Daniela Kondaj

Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Rakip Hazizaj

Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve

Arben Duka

Drejtor Juridik dhe Burimeve njerëzore

Delina Hoxha

KRYETAR

Majlinda BUFI

